

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRFITIMET NGA SHFRYTËZIMI I SHËRBIMEVE TË EKOSISTEMIT PYJOR, KOMPESIMI DHE PAGESAT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat, të cilat zbatohen nga ofruesit dhe përfituesit e këtyre shërbimeve. Konkretisht, ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, parashikon të drejtën e përfitimit nga shërbimet në ekosistem, si mundësinë për të marrë përfitimet që sigurohen nga funksionet natyrore të pyjeve dhe punimet e kryera në to, ku përfshihen kategoritë e shërbimeve si: shërbime të furnizimit për ushqim dhe ujë; shërbime rregullatore për parandalimin e përmbytjeve, thatësisë, sëmundjeve, degradimit të tokës (mbrojtja e tokës nga gërryerja, rrëshqitjet, mbrojtja e tokave bujqësore nga erërat, përthithja e karbonit, zhvillimi i faunës), të cilat lidhen edhe me ndryshimet klimaterike dhe mbrojtjen e biodiversitetit; shërbime mbështetëse për tokëformimin dhe ciklin e lëndëve ushqyese; shërbime kulturore që lidhen me rekreacionin dhe përfitime të tjera jomateriale.

Në lidhje me përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve në ekosistem, ligji parashikon se subjektet mund të përfitojnë nga këto shërbime dhe se strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki dhe agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura vlerësojnë shërbimet e ekosistemit, por nuk përeakton rregullat për përfitimin, kompensimin dhe pagesat. Për rrjedhojë bazuar në autorizimin ligjor të nenit 24 pika 4 të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, nëpërmjet këtij projektvendimi parashikohen rregullat për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat.

Objektivi që synohet të arrihet është përcaktimi i rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat, të cilat zbatohen nga ofruesit dhe përfituesit e këtyre shërbimeve.

Në vijim të sa më sipër, objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë:

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat”.

- Përcaktimi i kërkesave që duhet të plotësohen lidhur me shërbimet që ofrohen për përfitim në ekosistemin pyjor nga ofruesi i shërbimeve të ekosistemit pyjor.
- Ngritja e skemave të pagesave për shërbimet që ofrohen nga ekosistemet pyjore, ku përfituesit nga shërbimet e ekosistemit pyjor duhet të paguajnë ofruesit e shërbimeve të ekosistemit.
- Përcaktimi i rregullave për kompensimin e ofruesit të shërbimit për shërbimet në ekosistem, përmes kryerjes së veprimtarive të nevojshme për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e fondit pyjor në pronësi të tij, rehabilitimin e ekosistemit pyjor, mbrojtjen, përmirësimin dhe rigjenerimin e sipërfaqes pyjore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve, për vitin 2023, katërmujori III, i cili del në zbatim të nenit 24, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi gjen mbështetje dhe është në një linjë me përcaktimet/drejtimit e dhëna nga dokumente të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, si VKM nr.814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”.

Gjithashtu, projektvendimi është hartuar në përputhje me parashikimet e dokumenteve sektoriale që ndërthuren me pyjet.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pyjet si pasuri kombëtare, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe progresin e vendit, ndaj duhen pozicionuar në një linjë me politikën dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar, me kontribut të qenësishëm, duke zhvilluar sektorin nëpërmjet një sistemi të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, strategjive, programeve, dhe planeve të mbarështimit, duke integruar dhe optimizuar interesat midis pronarëve dhe administruesve të fondit pyjor si dhe përfituesve të shërbimeve të ekosistemit pyjor.

Relacion shpjegues për Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat”.

Shërbimet në ekosistemin pyjor që ofrohen nga fondi pyjor në pronësi publike dhe private, nga të cilat mund të përfitojnë subjekte të tjera, duhet të programohen e standartizohen, me qëllim që të krijohet mundësia e ngritjes së skemave të pagesave për shërbime në ekosistem. Në këtë kuadër, ngritja e skemave të pagesave për shërbime në ekosistem, si dhe përcaktimi i rregullave për shfrytëzimin e shërbimeve në ekosistemin pyjor krijon mundësi për gjenerimin e të ardhurave që sigurohen nga pagesat që vijnë nga përfituesit e shërbimeve të ekosistemit.

Propozimi i këtij vendimi synon të përcaktojë rregullat për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat, në përputhje me autorizimin ligjor sipas pikës 4 të nenit 24, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet". Gjithashtu, miratimi i këtij vendimi del si domosdoshmëri për formalizimin dhe unifikimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve në ekosistemin pyjor.

Për sa më sipër, vendimi i propozuar do të sjellë mundësinë për ngritjen e skemave për pagesat për shërbimet në ekosistem si dhe duke krijuar mundësi për gjenerimin e të ardhurave që vijnë nga ekosistemi pyjor, ku përfituesit e shërbimeve në ekosistem duhet të paguajnë ofruesit e shërbimeve të ekosistemit pyjor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës, në pikën 4 të nenit 24, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për Pyjet" dhe është në harmoni të plotë me kuadrin ligjor në fuqi për pyjet.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis e BE-së*, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Sa i përket formës së projektvendimit, sqarojmë se projektvendimi është i strukturuar me pika, në 4 krerë dhe 1 Shtojcë bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për shkak të përmbajtjes së shkurtër të dispozitave.

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat".

Në kreun I përcaktohet objekti dhe përkufizimet në kuptim të këtij vendimi.

Në kreun II, përcaktohen rregullat për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, si më poshtë:

- Shërbimet që ofrohen për përfitim në ekosistemin pyjor duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:
- të jenë në përputhje me planet e mbarështimit të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për pyjet;
- të jenë në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe/ose planin e detajuar vendor për zonën, në rast se ka;
- të jenë në harmoni me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm për pyjet;
- të mos çënojnë vlerat dhe funksionet natyrore e biologjike.
- Përfituesi duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për përfitimin e shërbimeve në ekosistem në formën e propozimit, e cila shoqërohet me një studim, i cili përmban:
- sipërfaqen (territorin) e fondit pyjor kombëtar të shprehur në metër katror (m²), me kufij të përcaktuar qartë, si dhe koordinatat gjeografike, metrike;
- përdorimin e tokës në sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar të njehsuar (m²), e cila cakton zonimin e brendshëm, ekonominë pyjore, numrin e parcelës, kufizimet natyrore dhe koordinatat, etj.;
- treguesit identifikues (kadastral) të ngastrave e nënngastrave;
- treguesit tekniko-ekonomik;
- treguesit tekniko-ekonomik për kullotat e livadhet;
- sipas rastit, studime të detajuara mbi erozionin, ndërtimin e modelit hidrologjik, në rast se ka.
- planin e menaxhimit të fondit pyjor, planet për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në këto sipërfaqe të fondit pyjor.
- Pas miratimit të projektit tekniko-ekonomik përkatës, titullari i institucionit/ kryetari i bashkisë ose personi i autorizuar prej tij nënshkruan me përfituesin një kontratë me shkrim për ofrimin e shërbimeve në ekosistem, që përmban detyrimet kryesore të secilës palë.
- ~~Kontrata nënshkruhet nga personi fizik ose juridik për shërbimet e ofruara në fondin pyjor privat dhe nga bashkia, për shërbimet e ofruara në fondin pyjor publik.~~
- Rregullat e përcaktuara në këtë kre, zbatohen edhe për shfrytëzimin e shërbimeve të ekosistemit pyjor, për fondin pyjor privat.

Në kreun III, parashikohen rregullat për kompensimin dhe pagesat nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, si vijon:

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat".

- Përfituesi i shërbimit, për të cilin është miratuar kryerja e shërbimeve në ekosistem, kryen pagesat përkatëse periodike ndaj ofruesit të shërbimit, për shërbimin përkatës që do të ofrohet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë vendim.
- Ofruesi i shërbimit kompensohet për shërbimet në ekosistem, përmes kryerjes së veprimtarive të nevojshme për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e fondit pyjor në pronësi të tij, rehabilitimin e ekosistemit pyjor, mbrojtjen, përmirësimin dhe rigjenerimin e sipërfaqes pyjore.

Në kreun IV, përcaktohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Shtojca I, paraqet formatin e kërkesës për përfitimin e shërbimeve të ekosistemit pyjor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtoria e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore), me asistencën e projektit "Promovimi i rimëkëmbjes së gjelbër në sektorin e pyjeve në Shqipëri" të financuar nga UNDP.

Projektvendimi u dërgua për mendim në ministritë e linjës, nëpërmjet sistemit e-aktet, konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrinë e Finances dhe Ekonomisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për shqyrtim nga Këshilli Konsultativ.

Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat".


IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTËR

Mirela KUMBARO BURXHI



Relacion shpjegues për Projektvendimin "Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompesimi dhe pagesat".